

Tevesuli

التوسل

< Shqip – Albanian – ألباني >




Abdullah Ahmed El-Huvejl

عبد الله بن أحمد الحويل



Përktheu: Jusuf Kastrati

ترجمة: يوسف كاستراتي

TEVESULI (AFRIMI)**Përkufizimi:**

Gjuhësisht, fjala *teuessul* (توسّل) rrjedh nga fjala *uesile* (وسيلة) që në shqip domethënë mënyrë, e cila në thelb nënkupton *diçka nëpërmjet së cilës arrijmë ose afrohemi te një gjë*.

Fjala *tevesul* në terminologjinë fetare nënkupton *marrjen e shkaqeve të lejuara, që na afrojnë te Allahu Fuqiplotë*.

Llojet e tevesulit:

1. Tevesul i ligjësuar (توسّل مشروع).
2. Tevesul i ndaluar (توسّل ممنوع).

Tevesuli i ligjësuar:

Tevesuli i ligjësuar është tri llojesh:

1. Tevesuli (afrimi te Allahu) nëpërmjet emrave dhe cilësive të Allahut.
2. Tevesuli që e bën lutësi nëpërmjet ndonjë vepre të mirë që e ka bërë.
3. Tevesuli, afrimi i robit te Allahu nëpërmjet duasë së ndonjë njeriu të mirë, i cili është i gjallë.

Tevesuli i ndaluar:

Çdo tevesul që nuk bën pjesë në ndonjërin nga tri llojet e tevesulit të ligjësuar, të cilat i përmendëm më lart, është i ndaluar. Këtu bëjnë pjesë:

1. Afrimi te Allahu nëpërmjet hakut dhe privilegjit të ndonjë personi.
2. Zotimi që bëhet për të dashurit e Allahut, njerëzit e mirë dhe duaja që u drejtohet atyre.
3. Therja e kurbanit për hir të të dashurve të Allahut dhe adhurimi që bëhet te varret e tyre.

